

- Fizika moderne e quan shekullin 20 – shekulli i revolucionarizimit të mendimit për kohën. Si u revolucionarizuaka mendimi për kohën, kur, sipas po kësaj fizike, nuk e dimë se çka është koha?
- Kur lexojmë shumë përkufizime për kohën, nga autorë të ndryshëm, shohim se ajo merr cilësorë të ndryshëm: koha është masë; koha është element; koha është medium, koha është hapësirë, koha është formë e ekzistencës së materies; koha është parametër emergjent; koha është parametër jo emergjent; koha është bllok i ndërtimit të Gjithësisë, koha është iluzion, koha nuk ekziston etj. Kjo shumësi e cilësorëve nuk tregon shkallë të lartë të njohjes së saj. Përkundrazi, tregon një mjegull të madhe në kuptimin e kohës.
- Koha rrjedh?! Sigurisht se nuk mund të rrjedhë madhësia fizike që quhet kohë, sepse nuk ka kuptim. Mund të thuhet se rrjedhin ngjarjet, rrjedhin zhvillimet e materies.
- Koha u bë mister me rastin e ri-krijimit të saj, që paraqet krijimin e dytë të kohës, pas krijimit të parë nga njeriu i lashtë. Ironike! Koha u bë mister nga shkenca përgjegjëse për shpjegimin bazik të saj dhe atë me rastin e 'revolucionarizimit' të saj.
- Koha është homonim i pa deshifruar. Ky deshifrim paraqet çelësin e kuptimit të kohës. Kur nuk dallohen dy kuptimet kryesore të homonimit 'kohë', përkufizimi i saj bëhet i pamundur, sepse, përkufizuesi humbë drejtpeshimin, ndërmjet atyre dy kuptimeve, të cilat megjithatë ekzistojnë në nënvetëdijen e tij. Për këtë arsye, përkufizuesi sa vrapon që të akomodojë ndryshimin e gjërave materiale në fjalën kohë, i del para matja e intervaleve kohore; sa e quan kohën bllok të ndërtimit të Gjithësisë, i del para koha e ardhme që nuk ekziston; sa e krahason me hapësirën, në të cilën shfaqen ngjarjet me radhë, i del para fakti se koha nuk ka dimension hapësinor; sa e bashkon kohën me hapësirën në një botë katërdimensionale, i del para fakti që një botë të tillë nuk mund ta konstruktojë dhe në të cilën koha është imagjinare; sa e quan kohën gjithçka (trupat dhe dukuritë që ndryshojnë), i del para ideja se ajo nuk shihet, nuk preket, nuk shijohet, nuk ka aromë. Koha do të vazhdojë të jetë mister, gjithnjë derisa fjala kohë mbulon dy gjëra të ndryshme, të veçanta, që kërkojnë përkufizim të veçantë, si dhe kërkojnë përkufizim të lidhjes funksionale ndërmjet tyre.
- Koha nuk është më shumë, as më pak, problem për t'u kuptuar, sesa masa, gjatësia, temperatura, shpejtësia, forca, vëllimi a ndonjë madhësi tjetër fizike. Nuk ka arsye që të qetësohemi me kuptimin e madhësive tjera fizike, e të shqetësohemi për kuptimin e kohës.

SHUKRI KLINAKU

ÇKA ËSHTË KOHA?

Si të largohet misteri nga ajo?

